



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2370, datë 18. 10. 2013

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz dhe 2110 – 2170 MHz, brezi - IMT””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|----------|
| 1. Znj. Alketa | Mukavelati | Kryetare |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Znj. Elkeda | Domi | Anëtare |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare Znj.Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 18.10.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - IMT””

BAZA LIGJORE:

1. Kodi i Procedurës Administrative (**Kpra**);
2. Shkronja g) dhe gj) e nenit 8, pika 2 e nenit 65, pika 1) dhe 2) e nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), i ndryshuar;
3. VKM Nr.322, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - IMT”;
2. Dokumenti për këshillim publik “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - IMT”;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumenti për këshillim publik “Mbi dhënien e një të drejte përdorimi në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - IMT” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
5. Hartimi i dokumentit është bazuar në pikën 2 të nenit 65, pikën 1 dhe 2) të nenit 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” si dhe përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike miratuar me VKM Nr.322, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
2. Qëllimi rregullator mbi dhënien në përdorim të këtyre frekuencave është:
 - të nxisë një konkurrencë sa më efektive në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre.
 - të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave ;
 - të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave) ;
 - të njohë cmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar ;si dhe të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, dhe ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar.

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtës së përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - IMT” sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Periudha e këshillimit publik fillon nga data e publikimit të dokumentit në mediat e shkruara kombëtare dhe është 45 ditë.
3. Njoftimi për këtë këshillim të botohet në gazeta të përditshme në vend.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURÇE

NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

MBI

DHËNIEN NË PËRDORIM TË BREZAVE TË FREKUENCAVE

IMT

1900-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me qëllim: nxitjen e një konkurrence sa më eficente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre sipas pikës 2 të nenit 65 të ligjit nr.9918 datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”. si dhe përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike miratuar me VKM Nr.322, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”; bazuar në: kompetencat, detyrimet dhe procedurën ligjore sipas shkronjës g) dhe gj) të nenit 8, dhe nenit 68 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, në plotësim të kërkesave të sipërmarrësve për frekuenca, nis këshillimin publik për dhënie të drejte përdorimi në brezat e frekuencave **IMT 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz**

AKEP, në mënyrë që :

- të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave;
- të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre vecanerisht pas ndryshimeve ne Planin Kombëtar të Frekuencave miratuar me VKM Nr. 466, datë 27.2.2013 (numrin e kërkesave) ;
- të njohë cmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar ; si dhe
- të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

zhvillon këtë këshillim publik përpara se të futet në procesin përfundimtar të dhënies në përdorim të këtyre brezave.

Materiali i mëposhtëm përmban opinione të AKEP, shpjegime si dhe pyetjet për pjesëmarrësit në këtë këshillim publik.

2. Të përgjithshme :

2.1 Sipas vlerësimit të kryer nga AKEP dhe rezultateve të proceseve të këshillimit publik të kryer me palët e interesuara për këtë qëllim më parë, bazuar dhe në percaktimet e VKM Nr.479 date 06.05.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (ku brezi ne fjale perdorim kryesor kishte IMT-2000 /UMTS) disponibiliteti i frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, ishte për dhënien e 4 (katër) të drejtave për përdorimin e tyre.

2.2 Me dhënien e tre Autorizimeve të mëparshëm Individual për përdorimin e frekuencave të brezit “Vodafone Albania” Sh.a., Albanian Mobile Communications Sh.a. dhe Eagle Mobile (Albtelecom sh.a.) nëpërmjet zbatimit të procedurës së tenderit publik miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, ka brez disponibel frekuencash në këto breza për të drejtë përdorimi.

Pjesëmarrësit në këtë këshillim janë të ftuar të bëjnë komentet e tyre mbi secilën nga ceshtjet, që janë trajtuar në këtë dokument.

Përgjigjet e marra do të bëhen publike dhe do të jenë pjesë e një informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin.

3. Synimi i AKEP është:

Implementimi i një procesi dhëniesh të drejtë përdorimi objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatoreve shqiptare dhe ekonomise shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit.

4. Grafiku i lëshimit të autorizimit

Plani Kombëtar i Radiofrekuencave (PKRF), vendimet dhe rekomandimet e CEPT/ECC, ligji për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, VKM Nr.322, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 1252, datë 10. 09. 2008 “ Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, i ndryshuar, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” (VKM Nr. 1252), i ndryshuar, etj., janë dokumentet kryesore që do të mbahen parasysh në trajtimin e këtij procesi.

AKEP mendon se interesi në kete brez frekuencash është më i madh se disponibiliteti për caktim në këtë brez. AKEP siguron këta operatorë të ardhshëm se procesi i dhënies së këtij autorizimi do të jetë transparent dhe konform legjislacionit në fuqi që kanë lidhje me këtë proces. AKEP parashikon se procedura e dhënies së këtij autorizimi mund të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2014.

5. Burimet e spektrit

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave përcakton brezat ku mund të autorizohen shërbimet IMT. Në përputhje me praktikën e ndjekur nga të gjitha vendet e Europës, AKEP propozon brezin:

Numri autorizimeve	Spektri ne perdorim per autorizimin individual
1	2x15 MHz spektër i çiftuar (1965-1980 - çiftuar me 2155-2170) dhe, 5 MHz spektër i paçiftuar (1915-1920)

Në kuptim të këtij dokumenti “spektër IMT” do të kuptojmë brezat e mësipërm të radiofrekuencave.

Kufizimi i numrit të të drejtave për të përdorur frekuencat lidhet me brezin e kufizuar në dispozicion të këtij shërbimi dhe me detyrimin e përdorimit sa më efikas të tyre.

Pyetja 1: A jeni dakort me këtë ndarje të brezave? Po me sasinë e spektrit për të drejtë përdorimi?

Numri i të drejtave që mund të jepen për përdorimin e frekuencave në brezat e frekuencave IMT, sipas tabelës së vendosur në paragrafin e 5-të të këtij dokumenti është 1 (një);

6. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit

AKEP mendon që vlefshmëria e autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Pyetja 2: A jeni dakort me këtë propozim?

7. Cmimi për brezat e dhënë në përdorim

AKEP ka dhënë tre Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave te brezit IMT (ish UMTS) dhe konkretisht :

- në brezin 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz për sipërmarrësin “Vodafone Albania” Sh.a., me vlerë 31.400.000 Euro, datë 02.12. 2010
- në brezin 1935,3-1950,/ 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz për sipërmarrësin Albanian Mobile Communications Sh.a. me vlerë 15.100.000 Euro, datë 28.09.2011
- dhe ne brezin 1950.1-1964.9/2140.1-2154.9 MHz dhe 1910.0 – 1915.0 per sipermarresin Eagle Mobile (Albtelecom sh.a.) me vlere 4.000.355 Euro me date 17.12.2012.

Pyetja 3: Cila është vlera që jeni të gatshëm të paguani për Autorizimin sipas përcaktimit të bërë në paragrafin 5 të këtij dokumenti?

8. Procedura e dhënies së Autorizimit

Për këtë çështje AKEP do të mbështetet në nenin 7, nenet 67, 68, 69 e në vazhdim të ligjit Nr. 9918 dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” dhe VKM nr. Nr.1252 datë 10.9.2008, i ndryshuar, dhe në rezultatet e këtij këshillimi publik.

Pyetja 4: A jeni dakort me këtë propozim?

9. Kriteret e kualifikimit

9.1 Kriteret e përzgjedhjes

Aplikimi i procedurës së tenderit publik të përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

Pyetja 5: A jeni dakort me këtë propozim?

9.2 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit të ofertave të jenë të njejta me ato të aplikuara në tenderat e meparshëm të zhvilluar për këtë qëllim:

- a- Çmimi i ofertës*
- b- Koha e mbulimit me shërbim*

AKEP fton sipërmarrësit të shprehen në lidhje me kriteret e mbulimit me shërbim në shkallë gjeografike të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shënime
Deri në fund të 6 mujorit të parë	Jo më pak se 35% të territorit
Deri në fund të 12 muajve	Jo më pak se 65% të territorit
Deri në fund të 18 muajve	Jo me pak se 85% të territorit

Pyetja 6: A jeni dakort me këtë propozim?

10. A ka ndonjë ceshtje tjetër për tu marrë në konsideratë në këtë proces?